



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-105
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 15.09.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Instituti për kontabilitet, auditim dhe financa- IKAF, në Prishtinë me adresë Rruga Bedri Pejani, Nr. 1, për periudhën 15.09.2017 deri 15.09.2020 me kualifikimin:

1.1. Nëpunës kontabiliteti, Niveli IV sipas KKK me 120 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

Nëpunës kontabiliteti

- 2.1. Planifikimi financiar për tri vitet e ardhshme, plus 2020.
 - 2.2. Raportet financiare të 3 viteve të fundit.
 - 2.3. Parashikimi i çmimores për kualifikimin.
 - 2.4. Agjenda (planin) e pjesëmarrjes së stafit edukativ në përsosjen e tyre (konferencat, seminarët).
 - 2.5. Personave me nevoja të veçanta t'iu mundësohet një qasje e arsyeshme në certifikim.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 10.11.2017 sipas raportit të jashtëm vlerësues për kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
 - IKAF;
 - AKK.



Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së